



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 36, Datë 18.02.2015

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK) me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|---------|
| - Znj. Klotilda Neziri | Kryetar |
| - Z. Zamir Moçka (Stefani) | Anëtar |
| - Znj. Ermonela Xhafa | Anëtar |
| - Z. Sokol Pasho | Anëtar |
| - Z. Zhani Shapo | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 18.02.2015, ka vijuar me shqyrtimin e çështjes me objekt :
“Ankesa e paraqitur nga Vodafone Albania ndaj Shoqërisë Albtelekom sh.a për praktikën tregtare të padrejtë në publicitetin “Eagle, rrjeti i vetëm 3.5 G/Eagle, the only 3.5G network””.

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, pas shqyrtimit të kësaj ankese,

VËREN SE:

Ankesa është paraqitur pranë Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve me shkresë nr. prot. LGD/0097/EZ Prot. datë 09.05.201. Ankesa konsiston në pretendimin se, praktika tregtare në ofertën “Eagle, rrjeti i vetëm 3.5 G/Eagle, the only 3.5G network”, është transmetuar në media vizive, publikuar në median e shkruar, në faqen zyrtare në internet dhe e shfaqur me anë të billboard-ve, kryesisht në Aeroportin “Nene Tereza”

Komisioni në muajin korrik me ane të shkresës nr. prot. 80/2, datë 08.07.2013, ka bërë me dije palët dhe Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare për fillimin e shqyrtimit administrativ të kësaj ankese.

Komisioni, në mbledhjen e datës 26.12.2014, ka vijuar me shqyrtimin e ankesës së Kompanisë Vodafone Albania, ka dëgjuar dhe përfaqësuesin/përfaqësuesit e kësaj kompanie, si dhe ka marre në dorëzim provat që ata kanë paraqitur. Përfaqësuesit e autorizuar kane sqaruar se praktika tregtare e ndjekur në vijimësi nga operatori Eagle Mobile (Albtelekom), ka dëmtuar konkurrencën e ndershme dhe interesat tregtare te kompanisë Vodafone Albania si dhe në te njëjtën kohe ka përcjellë informacion të pavërtetë për konsumatorin.

Në përfundim të mbledhjes së datës 26.12.2014, për një shqyrtim të plotë të kësaj çështje, në zbatim të nenit 52 të Ligjit nr. 9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe pikës 8 dhe 32, të VKM-se nr. 1444, dt.22.10.2008, Komisioni vendoi që ti kërkohej një informacion i përgjithshëm për këtë çështje si dhe, me specifikisht, në lidhje me zbatimin e Vendimit nr. 1774, datë 02.02.2012, nëse AKEP ka hapur procedura për tenderim publik për shërbimin 3.5 G.

Në mbledhjen e datës 18.02.2015, Komisioni ka vazhduar trajtimin e kësaj çështje nëpërmjet shqyrtimit të përgjigjes së AKEP, dhënë me shkresën nr. prot. 125/1, datë 3.02.2015, për shkresën e KMK nr. prot. 19, datë 19.01.2017. Në këtë shkresë, për sa i përket përdorimin të termit 3.5G, AKEP sqaron se “...Vendimi i AKEP nr. 1774, datë 02.02.2012, ndryshuar nga VKD nr. 2429, datë 13.03.2014 dhe VKD nr. 2443, datë 10.04.2014, është pjese e një procesi njoftimi” dhe se “3.5 G nuk është lloj shërbimi por teknologji dhe si i tille nuk autorizohet nga AKEP”

Komisioni ka marre në konsideratë dhe përgjigjen e Kompanisë Albtelekom, dërguar me shkresën nr. 2915/1, datë 11.04.2014, drejtuar AKEP dhe për dijeni KMK-se. Në të sqarohet se përmbajtja e mesazhit i referohet vetëm qëllimit komercial dhe angazhohet ta korrigjojë atë sipas kërkesës së AKEP.

Ndërkohë, edhe në përgjigjen e lartpërmendur të AKEP sqarohet se, Eagle Mobile (Albtelekom) ka marrë masat për ndryshimin e këtij publiciteti nga faqja zyrtare të këtij operatori, gjë që është konstatuar edhe nga vëzhgimet e Sekretariatit Teknik të KMK.

Në të gjithë dokumentacionin që Komisioni ka disponuar gjatë këtij proces shqyrtimi, përfshirë komunikimin shkresor të drejtpërdrejtë apo me statusin për dijeni, me AKEP, operatorët Vodafone Albania dhe Albtelekom, si dhe nga materialet e dorëzuara në cilësinë e provës, nga përfaqësuesit e Kompanisë Vodafone, nuk u arrit të provohet dëmtimi i drejtpërdrejtë i konsumatorëve ose “*dobësim i ndjeshëm i aftësisë së konsumatorit në marrjen e një vendimi, të cilin, në të kundërt, nuk do ta kishte marre*”, si pasojë e praktikës tregtare nëpërmjet publicitetit të Kompanisë Albtelekom. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi marrjen e masave, nga operatori, për heqjen e këtij publiciteti.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenet 13, 52, 49 shkronja (dh) dhe nenit 55 shkronja (a) të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në pikat 6 (a) dhe 31 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008,

VENDOSI:

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes, së ngritur nga Kompania Vodafone sh.a, ndaj Shoqërisë Albtelekom sh.a.
2. Për mos përsëritjen e rasteve/praktikave të tilla, të ngarkohet struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, që në bashkëpunim me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, të marrë masat, për një nismë për hartimin e një kodi sjelljeje mes operatoreve të fushës së komunikimit të telefonisë.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit, në baze të pikës 1 të nenit 59 të Ligjit 9902/2008, i ndryshuar, mund të bëhet ankim në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

KRYETAR I KOMISIONIT

KLOTILDA NEZIRI